




KONTRATË PUBLIKE - FURNIZIME

TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: **Furnizimi dhe montimi i pompave të ujit për ujësjellsin e Vidimiriqit**

Nr. i prokurimit ¹	642-25-4612-1-3-6
Nr i Brendshëm i Prokurimit	642-25-032-1-3-6
Nr i kontrates	642-25-4612-1-3-6/C738



AUTORITETI KONTRAKTUES

Komuna e Mitrovicës Jugore

OPERATORI EKONOMIK

Operatori Ekonomik – **"EJONA" SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja**

Neni 1 – Lënda

- 1.1. Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi dhe montimi i pompave të ujit për ujësjellsin e Vidimiriqit** nga **"EJONA" SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja**
- 1.2. Lënda e kontratës do të jetë (**Furnizim**) nga furnizuesi sipas pikës 1.1. të kësaj kontrate.
- 1.3. Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës nga të dyja palët dhe përfundon më **03.08.2025**.
- 1.4. Vendi i kryerjes së furnizimit është: **Fshati Vidimiriq**.

Neni 2 – Ligji i aplikueshëm

2.1. Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 – Çmimi

3.1. Çmimi i përgjithshëm i kontratës për **Furnizimi dhe montimi i pompave të ujit për ujësjellsin e Vidimiriqit**, shprehur me numra është: **8,282.89Euro**.

3.2. Çmimi i përmendur në paragrafin 3.1., duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i **KONTRATË: Furnizimi dhe montimi i pompave të ujit për ujësjellsin e Vidimiriqit Nr i Prokurimit 642-25-4612-1-3-6 dhe Nr i Brendshëm i Prok. 642-25-032-1-3-6**

nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 – Pagesat

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas furnizimeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të mallit (pompave të ujit) dhe pas pranimit nga zyrtari përgjegjës (verifikimi i produkteve) dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri i kontratës.

(Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë).

4.2. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 – Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2. Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës

Neni 6 – Kualiteti

6.1. Kualiteti i (Furnizimeve) duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe për përshkrimin e çmimeve.

Neni 7 – Garancioni

7.1. Garancioni do të mbetet valid për 36 muaj ose 3 vite në bazë të deklaratës së Kontaktorit në ofertën e prezentuar dhe në bazë të përshkrimit të çmimit dhe ofertës së dhënë AQP-së.

Neni 8 – Vonesat në ekzekutim

8.1. Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *(të kryej ndonjë ose të gjitha shërbimet)* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *(furnizimeve)* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 – Inspektimi dhe testimi

9.1. Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë marrë dhe testoj komponentët, materialet dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfardo artikulli që përgaditet, fabrikohet ose prodhohet për tu dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 – Nën-kontraktimi

10.1. Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 – Ndërprerja e kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1. Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim:

- a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar;
- c) Refuzon urdhat administrativ të Autoritetit Kontraktues;
- d) Ia jep dikuj kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti Kontraktues;
- e) Falimenton;
- f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*;
- g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare;
- h) Shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 – Ndërprerja e kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1. Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti Kontraktues:

- a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë;
- b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë;
- c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 – Komunikimi


14.1. Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën (Shqipe) në katër (4) origjinale, një (1) origjinale për Autoritetin Kontraktues, një (1) origjinal për Operatorin Ekonomik, një (1) origjinale për Njesinë Kërkuese dhe një (1) origjinale për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Mitrovicë Jugore	
Emri:	Kushtrim Mehaj
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	03.07.2025
Vula:	

Për Operatorin Ekonomik:

"EJONA " SH.P.K.,Zahaq, 30000, Peja	
Emri:	Lirie Dalipi Prelvukaj
Pozita:	Menaxher
Emajli	info@ejona.com
Nr UNIK	810089913
Nr i tel	+383 49137987
Nënshkrimi:	
Data:	03.07.2025
Vula:	



KUSHTET E VEÇANTA - KVK

Numri i PROKURIMIT: 642-25-4612-1-3-6 KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK

KPK		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	1.3	Data e Fillimit të Furnizimeve është pas nënshkrimit të kontratës dhe pas kërkesës së menaxherit të kontratës për furnizim.
	1.4	Data e Përfundimit është: 03/08/2025
	1.5	Vendi i kryerjes së furnizimeve është Fshati Vidimiriq- <i>Komuna e Mitrovicës JUGORE</i> (në Komunën e Mitrovicës Jugore)
Emrimi i Menaxherit të Kontratës	1.6	Menaxheri i Kontratës : caktohet me vendim nga ZKA
Parimet e përgjithshme të pagesës	1.10	Orari i pagesës do të jetë: Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas furnizimeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të mallit (furnizimit dhe montimit të pompave) dhe pas pranimit nga zyrtari përgjegjës (verifikimi i produkteve) dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri i kontratës. (Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë).
Kontrolli i kualitetit	1.11	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të furnizimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim:
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	1.12	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me	1.13	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën

KONTRATË: Furnizimi dhe montimi i pompave të ujit për ujësjellsin e Vidimiriqit Nr i Prokurimit 642-25-4612-1-3-6 dhe Nr i Brendshëm i Prok. 642-25-032-1-3-6

procedure gjyqësore	Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes,gjykata apo arbitrimi.
---------------------	---

Furnizim dhe montim me pompa te ujit per ujesjellsin e VIDIMIRIQIT me nr prokurimi 642-25-4612-1-3-6

Nr. rendor	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (Euro)	Çmimi njësi TVSH (Euro)	Çmimi njësi me TVSH (Euro)	Çmimi total (Euro)
1	Furnizim dhe montim me pompa vertikale (zhytese) P=15kw;N=2980RPM; Q=50-330l/min; H=112-370 m' (dalja Ø 63mm)	copë	2	1,648.00	296.64	1,944.64	3,889.28
2	Furnizim dhe montim me pompe Horizontale centrifugale (zhytese) P=7.5kw;N=2900RPM ;Q=100-400l/min; H=60-85 m'	copë	1	957.00	172.26	1,129.26	1,129.26
3	Furnizim me Orman per leshim te bute ne automatik per dy pompa(15kw)	copë	1	1,450.00	261.00	1,711.00	1,711.00
4	Furnizim dhe montim me orman per leshim te bute e automatik per nje pompe (7.5kw)	copë	1	700.00	126.00	826.00	826.00
5	Pune tjera, duke perfshire pershtatjen e te gjitha pompave(3copë) me gypat furnizues dhe shtytes brenda stacioneve ekzistuese.	paushall	1	616.40	110.95	727.35	727.35
						TOTALI:	8,282.89

VEREJTJE* Pompat duhet te jene me standarte Evropiane ose te pershtatshme per treg Evropian dhe me kualitet EU. Preferohen model Pedrollo ose te ngjashme.





REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER

YLLI S. MEKAJ

PEJË

LRP – Nr.rendor 9002/2020

Sot, me **date katërmëdhjetë tetor dymijënjëzet**, para meje Ylli S. Mekaj noter në zyrën e noterisë me seli në Pejë në rr., „General Wesley Clark” nr.10, paraqitet:-----

“Ejona” SH.P.K. e regjistruar në MTI me numër të biznesit 810089913 me seli në Zahaq/Pejë dhe e regjistruar me date 06.06.2000, të cilën në bazë të autorizimit LRP-Nr.Rendor:1060/2018 e datës 06.02.2018 e përfaqëson znj.Ejona Prelvukaj lindur 26.12.1996 në Pejë me banim në fshatin Vitomiricë Rajoni I/Pejë, shtetase e Kosovës, u identifikua nga letërnjoftimi me nr.pr.1170977692, lëshuar nga MPB/RKS, me zotësi veprimi. -----

Ajo në bazë të kompetencave të dhëna e bartë këtë:-----

A U T O R I Z I M

Autorizohet:-----

z.Arben Lajqi, i lindur me 27.02.1974 dhe me nr. personal 2009732937,-----

që në emër dhe për llogari të ndërmarrjes time që unë përfaqësoj të ndërmarrë veprimet si vijon -

***Të përfaqësoj ndërmarrjen time që pranë organeve kompetente shtetërore të mund të nënshkruaj kontrata të punës dhe të furnizimit dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për menaxhimin dhe përmbajtjen e kontratave të nënshkruara.**-----

I autorizuari im specifikisht ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e lartëcekura .-----

* Ky autorizim është i vlefshëm deri në revokim nga ana ime si dhënës i autorizimit. -----

Gjatë përpilimit të këtij autorizimi dëshmoj se janë respektuar të gjitha dispozitat të LNK-së. ----

Konstatohet se tek pala nuk ka pasur konfuzion apo paqartësi gjatë përpilimit të autorizimit -----

Konstatohet se origjinali i këtij akti i ipet palës, kopja mbetet tek noteri. -----

Dhënësit i autorizimit i lexohet ky akt dhe i njëjti deklaron se është shprehja e vullnetit të saj të plotë, të lirë dhe veprimet që do t'i ndërmerr i autorizuari i tij konform këtij autorizimi do t'i konsiderojë si veprime të tijat personale. I njëjti e nënshkruan pa vërejtje, ndërsa noteri të njëjtin e verteton.-----

Shpenzimet noteriale janë paguar në bazë të UA nr.02/2012 për tarifat e përkohshme noteriale, dhe atë në shumë prej 10 euro (dhjetë euro) plus TVSH.-----

Në zyrën noteriale me seli në rr., „General Wesley Clark”nr. 10 në Pejë.-----

Dhënësi i autorizimit

“Ejona” SH.P.K

Përsoni i autorizuar: Ejona Prelvukaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD – COMMERCIAL COURT

GjA.nr.2751/25
08.05.2025

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, në bazë të kërkesës së palës në kuptim të Rregullores Nr.07/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale të datë 29.07.2022, lëshon këtë: *PRIVREDNI SUD KOSOVA, na osnovu zahteva stranke u smislu Uredbe 07/2022 o Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematizaciji Radnih. Mesta u Privrednom Sudu od 29.07.2022, izdaje ovo:*

ÇERTIFIKATË
UVERENJE

Në regjistrat e Gjykatës Komerciale të Kosovës, *U registrima Privrednog suda Kosova*
Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik **Ejona SH.P.K. Pejë** me numër të regjistrimit **810089913** është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy (2) viteve të kaluara, dhe se ndaj të njëjtit është e iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit. *Nema dokaza da je ekonomski operator, sa brojem biznisa, proglašen pod stečajem ili nesolventan u protekle dve godine, i protiv istog, pokrenut postupak stečaja odnosno stečaja /likvidacije*

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. *Ovo Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.*

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesëmarrjes në **Grant** dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera. *Ista je zatražena od stranke s ciljem učesća za Grant, i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej pesë (5) €, e paraparë me nenin 12.17 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017. *Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5€, predviđeno članom 12.17 Administrativnog Upustva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017god.*

Afrim ADEMI

Referent i gjykatës / Referent Suda